

VENDIM
Nr. 40, datë 14.5.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 14.5.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 15 (L) 2023 që u përket:

KËRKUES: Lefter Koka, përfaqësuar nga avokati Tritan Hamitaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Dritan Prençi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-335, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 27, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I”, 135, 141, 142 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 3, 5, 6 dhe 18, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 28 dhe 71, e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Lefter Koka (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Ndaj kërkuarit janë regjistruar dy procedime penale: i. procedimi i parë nr. 187/2020, me akuzën për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 248 e 25, 260 e 25, 287/1, shkronjat “a” dhe “b” dhe 278/2, të Kodit Penal (*KP*), lidhur me procedurat e koncesionit/partneritetit publik me objekt “Ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë”; ii. procedimi i dytë nr. 277/2020 me të njëjtat akuza si në procedimin e parë, por në lidhje me procedurat e koncesionit/partneritetit publik me objekt “Ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan dhe prodhimin e energjisë”.

2. Ndaj kërkuesit është marrë dhe ekzekutuar masa e sigurimit “Arresti në burg” për të dyja procedimet dhe respektivisht ka kërkuar zëvendësimin me një masë më të lehtë, si “Arresti në shtëpi”, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore. Në vijim, do të parashtrohen në mënyrë të detajuar të dyja proceset gjyqësore penale të zhvilluara në ngarkim të kërkuesit.

I. Procesi i parë

3. Prokuroria e Posaçme, mbi bazën e kallëzimeve të bëra nga dy parti politike dhe nga “Nisma Thurje”, të cilat lidheshin me të njëjtin fakt penal, ka vendosur bashkimin e procedimeve penale dhe ka regjistruar për kërkuesin procedimin nr. 187 të vitit 2020 për veprat penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 258 dhe 248 të KP-së. Akuzat ndaj kërkuesit lidheshin me procedurat e zhvilluara në Bashkinë Fier për hartimin e planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane.

4. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 22 akti, datë 26.3.2022, midis të tjerave, ka vendosur ndaj kërkuesit caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunimin, të parashikuara përkatësisht nga nenet 248 e 25, 260 e 25, 287/1, shkronjat “a” dhe “b”, dhe 278/2 të KP-së.

5. Masa e sigurimit është ekzekutuar nga oficerët e Policisë Gjyqësore në datën 29.3.2022. Me vendimin nr. 23, datë 31.3.2022, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka verifikuar kushtet dhe kriteret e caktimit të masës së sigurimit, bazuar në nenin 248 të KPP-së, duke disponuar me vazhdimin e masës “Arresti në burg”, të caktuar me vendimin e sipërcituar.

6. Në datën 15.6.2022, kërkuesi i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës të Parë, duke kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit personal të arrestit në burg me një masë tjetër më të lehtë, “Arresti në shtëpi”, për shkak të gjendjes shëndetësore të përqësuar, së bashku me masën e sigurimit “garanci pasurore”.

7. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 269, datë 14.10.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj dhe në prova. Gjatë procesit, pas kërkesës së gjyqtarit të GJKKO-së është hartuar aktekspertimi mjekoligjor nr. 1742 nga mjekë specialistë të fushës për ekzaminimin në lidhje me vlerësimin e gjendjes shëndetësore të kërkuesit.

8. Kundër vendimit kërkuesi ka ushtruar ankim në apel dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*), me vendimin nr. 180, datë 24.11.2022, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 269, datë 14.10.2022, të GJKKO-së së Shkallës së Parë.

9. Kundër vendimit nr. 180, datë 24.11.2022, të GJKKO-së së Apelit ka ushtruar rekurs kërkuesi dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi masa e sigurimit “Arresti në burg” ishte rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural penal.

II. Procesi i dytë

10. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 100 akti, datë 12.12.2021, midis të tjerave, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara përkatësisht nga nenet 248 e 25, 260 e 25, 287/1, shkronjat “a” dhe “b”, dhe 278/2 të KP-së. Akuzat ndaj kërkuesit lidheshin me procedurat e zhvilluara në Bashkinë Elbasan për hartimin e planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane.

11. Masa e sigurimit është ekzekutuar në datën 14.12.2021. Me vendimin nr. 103, datë 16.12.2021, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka verifikuar kushtet dhe kriteret, sipas nenit 248 të KPP-së, dhe ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”.

12. Në datën 5.7.2022, kërkuesi i është drejtuar GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit personal të caktuar me vendimin nr. 100 akti, datë 12.12.2021, të GJKKO-së së Shkallës së Parë me një masë më të lehtë për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore.

13. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 297, datë 25.11.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj dhe në prova. Gjatë procesit, pas kërkesës së gjyqtarit të GJKKO-së, është hartuar aktekspertimi mjekoligjor nr. 2555 për ekzaminimin nga mjekë specialistë të fushës në lidhje me gjendjen shëndetësore të kërkuarit.

14. Kundër vendimit ka ushtruar ankim kërkuar dhe GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 3, datë 5.1.2023, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 297, datë 25.11.2022, të GJKKO-së Shkallës së Parë.

15. Kundër vendimit nr. 3, datë 5.1.2023, të GJKKO-së së Apelit ka ushtruar rekurs kërkuar dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-335, datë 23.2.2023, ka vendosur mospranimin e tij, pasi masa e sigurimit ishte rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural penal.

16. Në datën 17.10.2023 (*data e shërbimit postar*) kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023 dhe nr. 00-2023-335, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës, në datën 5.12.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

17. Kërkuar, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

17.1 *Trajtimin degradues, sipas nenit 3 të KEDNJ-së*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe gjykatat e posaçme kanë rrëzuar *apriori* mendimin e specializuar të mjekëve, si ekspertë, të cilët kanë arritur në përfundimin se mbajtja e kërkuarit në kushtet e burgimit është e papërshtatshme me gjendjen e tij shëndetësore, pavarësisht mundësisë së tij për të marrë mjekim. Gjykatat kanë arritur në një përfundim të kundërt me mendimin e ekspertëve dhe nuk kanë përmbushur detyrimin për të thirrur një grup tjetër ekspertësh për të konfirmuar ose rrëzuar aktin e ekspertimit. Analiza e Gjykatës së Lartë për të përdorur si kriter veprat penale, për të cilat akuzohet kërkuar, bie në kundërshtim me natyrën e nenit 3 të KEDNJ-së, i cili mbron një të drejtë absolute. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka pranuar se lirimi në situata të tilla mund të parashikohet edhe për persona shumë të rrezikshëm. Kërkuar, duke mos iu ndryshuar masa e sigurimit, i janë rrezikuar jeta dhe shëndeti, pasi në kushtet e burgimit, nuk mund t'i ofrohet kujdes shëndetësor i shpejtë.

17.2 *Cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

17.2.1 *Lirisë personale të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në të gjitha vendimet që kanë miratuar masën e arrestit në burg, gjykatat, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, nuk kanë analizuar domosdoshmërinë e masës së sigurimit të arrestit në burg. Shkaku për zëvendësimin e masës së sigurimit ka qenë gjendja e rënduar shëndetësore dhe se qëndrimi në paraburgim mund t'i dëmtojë rëndë shëndetin dhe jetën. Kushtet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (*IEVP*), Durrës se nuk ka autoambulancë, mungon stafi mjekësor, ka mbipopullim dhe protokoli i Policisë së Burgjeve nuk lejon që pacienti i paraburgosur të marrë të njëjtin shërbim si një pacient civil, janë konstatuar edhe nga institucioni i Avokatit të Popullit. Pretendimet e paraqitura në rekurs ishin të natyrës kushtetuese, sepse lidheshin me të drejtën e lirisë personale dhe lëvizjes së lirë, të parashikuar nga neni 27 i Kushtetutës. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk është mjaftueshëm i arsyetuar, argumentet janë të përgjithshme e abstrakte, si dhe nuk janë argumentuar arsyet për rrëzimin e kërkesës për caktimin e masave alternative shtrënguese më të lehta. Ndonëse në rekurs ishin parashtruar pretendime që lidhen me interpretimin e neneve 228, 229 dhe 230 të KPP-së, nuk është dhënë përgjigje e argumentuar dhe i është shmangur arsytimit të kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është kontradiktor në vendim dhe nuk ka arsyetuar për tre kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së.

17.2.2 *Së drejtës së aksesit në gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka zbatuar afatin ligjor 30-ditor për njoftimin e datës së seancës gjyqësore. Për çështjen e përfunduar me vendimin nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në dosje mungon shpallja e bërë në këndin e njoftimeve të asaj gjykate dhe nuk ka asnjë të dhënë për caktimin e gjyqtarit zëvendësues, ndërsa për procesin e përfunduar me vendimin nr. 00-2023-335, datë 23.2.2023, rezulton se gjyqtari zëvendësues është caktuar me short manual ditën e gjyqimit dhe në buletinin e njoftimeve nuk është njoftuar data e re, si dhe gjyqtari zëvendësues.

Për të gjitha këto arsye trupi gjykues që ka shqyrtuar rekursin është krijuar në kundërshtim me nenin 436, paragrafi 2, të KPP-së, duke cenuar edhe *të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*.

17.2.3 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi vendimi i trupit gjykues prej tre gjyqtarësh bie ndesh me praktikën e Gjykatës së Lartë, që ka pranuar se zbutja e masave të sigurimit mund të jetë edhe pasojë e gjendjes së rënduar shëndetësore të kërkuarit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta dërgonte çështjen për njësim të praktikës gjyqësore lidhur me faktin nëse për zëvendësimin e masës së sigurimit nevojitet një aktekspertimi mjekoligjor për konstatimin e gjendjes shëndetësore, kur kujdesi shëndetësor i të paraburgosurit është i njëjtë me personin në gjendje të lirë, si dhe nëse praktikisht këta dy persona mund të kenë kujdes shëndetësor në kushte të njëjta. Qëndrimi ndryshe i Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë ka *cenuar edhe parimin e sigurisë juridike*.

18. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet për mospranimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore lidhen me zbatimin e ligjit procedural dhe material nga gjykatat. Akti i ekspertimit mjekoligjor nuk është detyrues, por ndihmues për gjykatën në lidhje me formimin e bindjes së saj, duke u bazuar në rrethanat faktike dhe konkluzionet shkencore. Nga ana tjetër, duhet të konsiderohet edhe humbja e vlerës në kohë të aktit, i cili ka bërë një vlerësim të situatës shëndetësore në datën 29.7.2022 dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka të dhëna nga Drejtoria e Burgjeve për kërkesë nga personeli mjekësor i IEVP-së, Durrës, ku mbahet kërkuari, për një trajtim mjekësor të specializuar. Ligji nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" (ligji nr. 81/2020) i siguron personit nën hetim të gjitha kushtet: mjekësore, përshtatshmërinë e ndihmës dhe të përkujdesjes mjekësore, si dhe garantimin e masave të burgimit në përputhje me gjendjen shëndetësore, në zbatim edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin se akti i ekspertimit mjekoligjor nuk është bindës dhe se çështja konkrete nuk është në të njëjtat kushte si rastet e referuara nga praktika e GJEDNJ-së për zëvendësimin e masës së sigurimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

19. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "P", 134 dhe pikat 1, shkronja "I" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

20. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues, do të vlerësohet legjitimitimi i kërkuarit, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

21. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata vlerëson se kërkuari, si individ, legjitimohet në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pika 1, shkronja "I", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proceset gjyqësore penale në të cilat janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

22. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individit pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohe vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 17.3.2022; nr. 14, datë 11.3.2022; nr. 29, datë 30.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Si përjashtim, Gjykata ka vlerësuar se vendimet që lidhen me masën e sigurimit të arrestit me burg, konsiderohen përfundimtare për

qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 75, datë 22.12.2015; nr. 40, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Rregulli i shterimit të mjeteve juridike nënkupton jo vetëm që kërkuesi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t’i drejtohet Gjykatës, por edhe që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë, t’i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në përmbushjen e këtij kriteri, Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet për masën e sigurimit të arrestit në burg bazuar në kërkesën për zëvendësimin e saj. Po kështu, Gjykata konstaton se të gjitha pretendimet e paraqitura në ankimin kushtetues individual janë parashtruar përpara gjykatave të posaçme, pra në këtë kuptim ato përmbushin kriterin e shterimit edhe në substancë, jo vetëm në formë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

24. Gjykata vëren se për legjitimitimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, kërkuesi ka pretenduar se për vendimet e Kolegjit Penal ka marrë dijeni në datën 25.8.2023, ditën kur ka aplikuar për të marrë vendimet e Kolegjit Penal. Në mbështetje të pretendimit të tij, kërkuesi ka parashtruar se vendimet objekt kundërshtimi nuk i janë njoftuar, fakt i konfirmuar edhe nga shkresa nr. 2178/1 prot., datë 8.9.2023, e GJKKO-së së Shkallës së Parë, e cila ka sqaruar se pas verifikimit të dosjes gjyqësore, në fashikullin gjyqësor të Gjykatës së Lartë nuk ndodhet dëftesa e komunikimit të vendimit nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Vendimet janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 18.5.2023, por kërkuesi ka paraqitur një shkresë të IEVP-së, Durrës, sipas së cilës ai nuk ka mundësi përdorimi të internetit në mjediset e paraburgimit.

25. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se, në rastin konkret në kushtet e veçanta që ndodhet kërkuesi, ato të izolimit në IEVP, Durrës, nisur nga data 25.8.2023 kur ai ka pasur mundësi të njihet efektivisht me vendimet, ankimi kushtetues individual i paraqitur në datën 17.10.2023, konsiderohet brenda afatit ligjor 4-mujor.

26. Lidhur me kriterin e legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar se vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë janë rrjedhojë e një procesi të parregullt për shkak të cenimit të: i. nenit 3 të KEDNJ-së (trajtimi degradues); ii. lirisë personale të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor; iii. së drejtës së aksesit në gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me mbrojtjen efektive; iv. së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

27. Gjykata vëren se për pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me mbrojtjen efektive, kërkuesi ka parashtruar se kjo e drejtë është cenuar për shkak të mosrespektimit të rregullave të shortit për caktimin dhe ndryshimin e gjyqtarëve të trupit gjykues në Gjykatën e Lartë, si dhe për shkak të moszbatimit të afatit 30-ditor për njoftimin e datës së seancës, duke mos i dhënë mundësi të paraqesë parashtrimet e tij.

28. Për pretendimin për mozbatimin e rregullave të shortit dhe zbatimin e shortit manual për caktimin e gjyqtarit zëvendësues, Gjykata konstaton se nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të vendimit nr. 00-2023-313, datë 23.2.2023, në datën 2.2.2023, është bërë njoftimi me shpallje për zhvillimin e seancës në dhomën e këshillimit në datën 16.2.2023. Po në datën 16.2.2023, ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi një gjyqtar i trupit gjykues dhe me vendimin nr. 82 prot., datë 16.2.2023, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur pranimin e saj. Në datën 17.2.2023, është bërë njoftimi me shpallje për zhvillimin e seancës në datën 23.2.2023, duke njoftuar edhe përbërjen e trupit gjykues. Ndërsa në lidhje me procesin gjyqësor të përfunduar me vendimin nr. 00-2023-335, datë 23.2.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, rezulton se njoftimi me shpallje mban datën 10.2.2023, për zhvillimin e seancës në dhomën e këshillimit në datën 16.2.2023. Po këtë ditë ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga ky gjykim i njëjti gjyqtar i trupit gjykues, si në procesin e parë. Me vendimin nr. 81 prot., datë 16.2.2023, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur pranimin e saj. Në datën 17.2.2023, është mbajtur procesverbal për plotësimin e trupit gjykues për shkak të heqjes dorë nga gjykimi i çështjes të gjyqtarit dhe po këtë ditë është bërë shpallja për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në datën 23.2.2023, duke njoftuar edhe përbërjen e trupit gjykues.

29. Në analizë të rrethanave të mësipërme, Gjykata vëren se nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë mosrespektimin e rregullave procedurale në Gjykatën e Lartë për caktimin e trupit gjykues dhe zëvendësimin e një prej anëtarëve. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se çështja e kërkesit në Gjykatën e Lartë është ndarë me short elektronik, duke iu caktuar njërit prej gjyqtarëve të kolegjit të saj penal, ndërsa trupi gjykues është formuar edhe me dy anëtarë të tjerë, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Gjykatës për shpërndarjen e gjyqtarëve në trupa gjykues. Në vijim, Gjykata vëren se për shkak të largimit (me dorëheqje) të një prej anëtarëve të trupit gjykues, ai është zëvendësuar nga një gjyqtar tjetër po i Kolegjit Penal, i përzgjedhur me short, i cili në këtë rast është kryer manualisht. Lidhur me këtë, Gjykata vlerëson se shorti manual nuk është një praktikë e përjashtuar në caktimin e gjyqtarëve, gjithmonë kur ajo bëhet në funksion të mirëadministrimit të drejtësisë dhe menaxhimit efektiv të situatave që mund të lindin në raste të veçanta. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente konkrete në mbështetje të pretendimit për të provuar se si zbatimi i këtij mekanizmi përzgjedhjeje të një prej anëtarëve të trupit gjykues ka cenuar procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në drejtim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

30. Lidhur me pretendimin për mosrespektimin e afatit ligjor 30-ditor të përcaktuar nga KPP-ja për njoftimin e datës së seancës, Gjykata evidenton se, referuar dispozitave që rregullojnë rekursin në Gjykatën e Lartë, shqyrtimi në këtë gjykatë kalon në një ose në dy faza. Në fazën seleksionuese, sipas nenit 433 të KPP-së, shqyrtohen në dhomën e këshillimit kushtet e pranueshmërisë së rekursit dhe në mungesë të tyre Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë disponon me mospranimin e tij, duke i dhënë fund shqyrtimit. Vetëm nëse rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore (faza e dytë), që, si rregull, zhvillohet në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve (neni 436/a i KPP-së) ose në prani të palëve (neni 437 i KPP-së), rast në të cilin bëhet edhe njoftimi i palëve për datën dhe orën e gjykimit sipas mënyrave përkatëse të përcaktuara nga KPP-ja (neni 436).

31. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa/rekursi për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” me një masë më të lehtë i është nënshtruar shqyrtimit seleksionues nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili në dhomën e këshillimit (pa pjesëmarrjen e palëve) ka vendosur mospranimin e saj, pasi nuk plotësonte kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në këtë drejtim, bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk i është mohuar e drejta për t’u njoftuar dhe më tej mbrojtja efektive, pasi në fazën seleksionuese ligji nuk parashikon njoftimin e palëve, për rrjedhojë pretendimi për mosrespektimin e afatit ligjor 30-ditor për njoftimin e seancës nuk qëndron. Po kështu, Gjykata evidenton se, për shkak të natyrës së çështjes që lidhet me një masë paraburgosjeje, pra me lirinë e personit, shqyrtimi me shpejtësi i çështjes nga gjykatat përbën detyrim që vjen nga neni 28, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 5, pika 3, i KEDNJ-së, që i korrespondojnë së drejtës së personit të paraburgosur për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

32. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me mbrojtjen efektive është haptazi i pabazuar.

33. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me parimin e sigurisë juridike, pasi vendimet e Kolegjit Penal bien në kundërshtim me praktikën e Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se vendimet e referuara nga kërkuesi nuk janë njësuere të praktikës gjyqësore, për rrjedhojë nuk janë detyruese për zbatim gjatë shqyrtimit të një çështjeje nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Për sa i përket pretendimit se çështja duhej të kishte kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, për qëllim të njësimi të praktikës gjyqësore, Gjykata vlerëson se kjo është një çështje e mënyrës së zbatimit të ligjit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili vlerëson nëse në një çështje të caktuar është përpara rastit për të vendosur kalimin për shqyrtim në seancë gjyqësore në prani të palëve, sipas nenit 437 të KPP-së ose njësimin e praktikës, sipas nenit 438 të po këtij kodi. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe për pretendimin për cenimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me parimin e sigurisë juridike kërkuesi nuk ka parashtruar argumente kushtetuese.

34. Në vijim, Gjykata konstaton se kërkuesi edhe në lidhje me cenimin e nenit 3 të KEDNJ-së, për trajtimin degradues, nuk ka parashtruar argumente konkrete, por pretendimet i ka lidhur me mënyrën e arsyetimit të Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë tjetër më të lehtë për shkak të gjendjes shëndetësore, ndaj Gjykata çmon ta

analizojë çështjen në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, Gjykata do të analizojë bazueshmërinë në themel të pretendimeve në drejtim të cenimit të lirisë personale të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e lirisë personale të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

35. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar se në të gjitha vendimet, gjykatat, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, nuk kanë analizuar domosdoshmërinë e masës së sigurimit të arrestit në burg. Shkaku për zëvendësimin e masës së sigurimit ka qenë gjendja e rënduar shëndetësore dhe se qëndrimi në paraburgim mund t'i dëmtojë rëndë shëndetin dhe jetën. Pretendimet në rekurs ishin të natyrës kushtetuese, sepse lidheshin me lirinë personale. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk është mjaftueshëm i arsytuar, është kontradiktor, argumentet janë të përgjithshme e abstrakte, dhe ky kolegji nuk ka arsytuar për tre kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së.

36. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, duke konfirmuar qëndrimin e gjykatave të posaçme më të ulëta për zbatimin e ligjit nr. 81/2020, për trajtimin shëndetësor të tij dhe se në rastin konkret nuk jemi përpara rasteve të referuara nga praktika e GJEDNJ-së për zëvendësimin e masës së sigurimit. Akti i ekspertimit mjekoligjor nuk është detyrues, por ndihmues për gjykatën në lidhje me formimin e bindjes së saj dhe pretendimet lidhen me zbatimin e ligjit nga gjykatat.

37. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shprehja "c"*).

38. Sipas Gjykatës, kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe konkretisht me lirinë e personit (*shih vendimet nr. 51, datë 18.10.2023; nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 40, datë 18.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Masa e sigurimit personal mund dhe duhet të ndryshohet, duke u zëvendësuar me një më të lehtë ose më të rëndë, në varësi të ndryshimit të kushteve që ekzistojnë kur ajo është caktuar (*shih vendimin nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në lidhje me zbutjen e nevojave të sigurimit, GJEDNJ-ja ka përcaktuar tre elemente/kritere referuese: i. kushtet mjekësore të të burgosurit; ii. përshtatshmërinë e ndihmës dhe përkujdesjes mjekësore, të parashikuara sipas kushteve spitalore të burgut; iii. përshtatshmërinë e masës së sigurimit në përputhje me gjendjen shëndetësore të ankuesit (*shih Melnik kundër Ukrainës, datë 28.3.2006, § 94*).

40. Referuar nenit 260, pika 2, të KPP-së gjykata e zëvendëson masën e sigurimit me një tjetër më të lehtë kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet. Ndërsa në pikën 2, të nenit 230 të po këtij kodi, mes të tjerave, parashikohet se "Arresti në burg" nuk mund të vendoset ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë.

41. Për sa i takon standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, që i garantohet individit nga nenit 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore (*shih vendimet nr. 4, datë 31.1.2024; nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të

kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit kushtetues, vendimi për kufizimin e lirisë personale të kërkuesit është bërë bazuar në rezultatet e hetimit dhe materialet për secilën çështje. Nga analiza tërësore e fakteve, rrethanave dhe akteve, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, për të dyja procedimet penale, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, për të cilat kërkuesi ka kërkuar zëvendësimin me një masë më të lehtë, “Arresti në shtëpi”, për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore si pasojë e sëmundjeve.

44. Pas shqyrtimit të çështjes GJKKO-ja e Shkallës së Parë (në të dyja proceset) ka vendosur rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, duke arsyetuar se pavarësisht përfundimit të ekspertëve se gjendja shëndetësore aktuale e kërkuesit paraqitet “veçanërisht e rëndë”, ky konkluzion nuk është i detyrueshëm për gjykatën dhe se kjo gjendje nuk mund të interpretohet *apriori* si një rrethanë që pengon caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg. GJKKO-ja e Shkallës së Parë (në të dyja proceset) ka arsyetuar se rregulli që ndaj një personi në gjendje veçanërisht të rëndë nuk mund të caktohet masa e sigurimit e arrestit të burg është i përgjithshëm dhe se në rastin konkret gjen zbatim pika 3, e nenit 230 të KPP-së, sipas së cilës arresti në burg mund të vendoset vetëm për shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se 10 vjet burgim. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë (në të dyja proceset), sëmundjet që i janë diagnostikuar kërkuesit mund të ndikojnë në gjendjen e tij shëndetësore kudo që të ndodhet, në mjediset e shtëpisë, të IEVP-së ose Institucionit të Veçantë të Kujdesit Shëndetësor të të Burgosurve, pasi trajtimi i tyre është i njëjtë si në kushtet e paraburgimit, ashtu edhe në mjediset e tjera, prandaj në rastin në shqyrtim nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë që të përligjë zbutjen e masës së sigurimit, në përputhje me kërkesat e nenit 260 të KPP-së.

45. Pas ankimit të kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit (në të dyja proceset) ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar në të njëjtën linjë si GJKKO-ja e Shkallës së Parë se në rastin konkret nuk provohet pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese përkatëse në institucionin mjekësor ku trajtohen të paraburgosurit ose në një institucion të specializuar mjekësor. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se mendimi i ekspertëve se sëmundjet nga të cilat vuan kërkuesi nuk mund të kurohen në kushtet e paraburgimit tejkalon fushën shkencore që ata mbulojnë dhe se autoriteti kompetent që konfirmon mundësinë ose pamundësinë e ofrimit të kujdesit shëndetësor gjatë paraburgimit është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas ligjit nr. 81/2020. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se në rastin e kërkuesit ofrohet kurimi i përshtatshëm edhe gjatë zbatimit të masës së arrestit në burg dhe ky trajtim është në një nivel proporcional me trajtimin që shteti shqiptar u siguron qytetarëve të tij në tërësi, e, për pasojë në respektim të ndalimeve të nenit 3 të KEDNJ-së. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se nuk verifikohet prania e gjendjes “veçanërisht e rëndë”, siç kërkon paragrafi 2, i nenit 230 të KPP-së.

46. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në të dyja proceset, ka vendosur mospranimin. Ky Kolegji Penal, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se edhe pse në disa vendime është mbajtur qëndrimi se jo çdo sëmundje e të arrestuarit mund të trajtohet si rast për mosaplikimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” ose për zëvendësimin e saj me një masë tjetër më të lehtë, me përjashtim të rastit kur ndodhemi përpara një gjendjeje “veçanërisht të rëndë shëndetësore”, një rrethanë e tillë nuk mund të merret “*apriori*”, duke u mbështetur në çfarëdolloj pretendimi të palës kërkuese, pasi gjykata arrin në përfundim vetëm nëpërmjet një akteksperimenti mjekoligjor, të caktuar sipas rregullave procedurale penale, në konkluzionet e të cilit duhet të përcaktohet qartë “gjendja veçanërisht e rëndë shëndetësore” e të arrestuarit, njëkohësisht edhe “pamundësia e qëndrimit të mëtejshëm në izolim ose në kushtet spitalore të burgut”. Në arsyetim, Kolegji Penal, mes të tjerave, ka vlerësuar se nga ana e ekspertëve nuk është provuar pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese përkatëse në institucionin mjekësor ku trajtohen të paraburgosurit ose në një institucion të specializuar mjekësor. Në lidhje me pajtueshmërinë e gjendjes shëndetësore të personit nën hetim, në zbatim të tre kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, Kolegji Penal është shprehur se vetëm në ato raste kur nga ana e autoritetit shtetëror mbikëqyrës të paraburgimit nuk mund të sigurohet një trajtim i kualifikuar mjekësor i sëmundjes dhe

mungesa e tij vë në rrezik jetën ose shëndetin, gjendja shëndetësore e personit mund të shërbejë si shkak për ndryshimin e masës së sigurimit (*shih paragrafët 37–38, të vendimit nr. 00-2023-313 dhe 51–54, të vendimit nr. 00-2023-335, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

47. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vijuar me arsyetimin se ligji nr. 81/2020 garanton të drejtën e trajtimit mjekësor në institucionet e ekzekutimeve penale dhe se kërkuesi ka të drejtë të kryejë vizitat mjekësore në një institucion të kujdesit shëndetësor brenda vendit të zgjedhur prej tij, përfshirë këtu edhe një spital privat (edhe pse ai është nën masën e sigurimit “Arresti në burg”). Sipas tij, kërkuesi është trajtuar pranë Institucionit të Veçantë të Kujdesit Shëndetësor të Burgosurve, duke marrë trajtimin e kualifikuar mjekësor dhe me konsulta të herëpashershme me specialistë të fushës, për rrjedhojë Kolegji Penal ka vlerësuar se nuk ndodhet përpara kritereve të përcaktuara nga GJEDNJ-ja dhe nuk ka vend për zëvendësimin e masës së sigurimit për shkak të gjendjes shëndetësore (*shih paragrafët 40, 41.3. dhe 42, të vendimit nr. 00-2023-313 dhe 59, të vendimit nr. 00-2023-335, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

48. Për sa më lart, duke pasur në vëmendje kriteret e vendosura nga GJEDNJ-ja për zbutjen e masave të sigurimit, Gjykata vlerëson se nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është arsyetuar vazhdimi i masës së sigurimit të arrestit në burg, duke konsideruar kushtet mjekësore të kërkuesit (*kriteri i parë*), që pavarësisht vlerësimit të mjekëve është konkluduar se mund të kurohet në mjediset e paraburgimit, pra nuk është provuar pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapi mjekësore si në institucionin mjekësor kur trajtohen të paraburgosurit, ashtu edhe në një institucion të specializuar mjekësor, duke u përshtatur ndihma dhe përkujdesja mjekësore ndaj tij (*kriteri i dytë*) dhe se verifikimi i vazhdimësisë së masës së sigurimit të arrestit në burg është në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore (*kriteri i tretë*). Po kështu, kjo gjykatë, në rastin konkret, ka analizuar nëpërmjet një interpretimi sistematik, bazuar në kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 81/2020 dhe dispozitat e KPP-së, përmes të cilave u ka dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkuesit për cenimin e lirisë personale dhe mosplotësimin e kritereve për zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg me një masë më të lehtë.

49. Në vështrim të analizës së mësipërme dhe standardeve kushtetuese e konventore, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

50. Në përfundim, Gjykata çmon se nuk ka shkelje të nenit 27 të Kushtetutës, të lidhur me nenin 42 të saj, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj dhe kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 14.5.2024.

Shpallur, më 18.6.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Ilir Toska, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

Anëtar kundër: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Lefter Koka, me objekt shfuqizimin e dy vendimeve të Gjykatës së Lartë të dhëna në datën 23.2.2023 dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim

në po atë gjykatë, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë që ajo duhej të ishte pranuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashitrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Në vitin 2020 ndaj kërkuarit janë regjistruar dy procedime penale për akuzat e veprave penale të parashikuara nga nenet 248 e 25, 260 e 25, 287/1, shkronjat “a” dhe “b”, dhe 278/2 të KP-së lidhur me procedurat e koncesionit/partneritetit publik për ndërtimin dhe administrimin e dy impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane për prodhimin e energjisë për qarqet Fier dhe Elbasan. Për të dyja procedimet është urdhëruar masa e sigurimit personal e arrestit në burg.

3. Pas caktimit të masave të sigurimit për të dyja proceset penale (në datat 12.12.2021 dhe 26.3.2022), kërkuari i është drejtuar gjykatës respektivisht pas 7 muajve (në datën 5.7.2022) dhe rreth 3 muajve (në datën 15.6.2022) me dy kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me atë të arrestit në shtëpi për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore. Gjatë gjykimit të kërkesave është urdhëruar kryerja e ekspertimit mjekoligjor të kërkuarit, ku në përfundim ekspertët kanë konkluduar se qëndrimi në izolim, në kushtet e paraburgimit, referuar diagnozës, përbën rrezik për shëndetin e tij, pasi *“sëmundjet nga të cilat ai vuan nuk mund të kurohen në kushtet e paraburgimit, në ambientet e IEVP-së në të cilat ndodhet”*.

4. Pavarësisht kësaj, gjykatat e të tria shkallëve e kanë rrëzuar kërkesën për ndryshimin e masës së sigurimit, duke u shprehur, ndër të tjera, se konkluzioni i ekspertëve se gjendja shëndetësore aktuale e kërkuarit paraqitet *“veçanërisht e rëndë”*, nuk është i detyrueshëm për gjykatën dhe se kjo gjendje nuk mund të interpretohet *apriori* si një rrethanë që pengon caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg. Gjithashtu, sipas gjykatave, nuk provohet pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese përkatëse në institucionin mjekësor ku trajtohen të paraburgosurit ose në një institucion të specializuar mjekësor. Ato kanë vlerësuar se mendimi i ekspertëve se sëmundjet nga të cilat vuan kërkuari nuk mund të kurohen në kushtet e paraburgimit tejkalon fushën shkencore që ata mbulojnë dhe se autoriteti kompetent që konfirmon mundësinë ose pamundësinë e ofrimit të kujdesit shëndetësor gjatë paraburgimit është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Po kështu, kërkuarit i ofrohet kurimi i përshtatshëm edhe gjatë zbatimit të masës së arrestit në burg dhe ky trajtim është në një nivel proporcional me trajtimin që shteti shqiptar u siguron qytetarëve të tij në tërësi.

5. Në vijim, kërkuari i është drejtuar Gjykatës, duke pretenduar se vendimet e kundërshtuara janë rrjedhojë e një procesi të parregullt për shkak të cenimit të: i. të nenit 3 të KEDNJ-së (trajtim degradues); ii. standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me lirinë personale; iii. së drejtës së aksesit në gjykatën e caktuar me ligj të lidhur me mbrojtjen efektive; iv. së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me parimin e sigurisë juridike. Shumica dy pretendimet e fundit i ka vlerësuar si haptazi të pabazuara dhe të paparashtruara me argumente kushtetuese (*shih paragrafët 29, 32 dhe 33, të vendimit*). Ndërsa lidhur me pretendimin për trajtimin degradues, sipas nenit 3 të KEDNJ-së, ka evidentuar se kërkuari nuk ka paraqitur argumente konkrete duke e analizuar atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe konkretisht në drejtim të cenimit të lirisë personale të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih paragrafin 34 të vendimit*).

6. Në përfundim, shumica ka rrëzuar kërkesën, duke argumentuar se Gjykata e Lartë ka arsyetuar vazhdimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, duke konsideruar kushtet mjekësore të kërkuarit dhe që pavarësisht vlerësimit të mjekëve, nuk është provuar pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese, qoftë në institucionin mjekësor kur trajtohen të paraburgosurit, ashtu edhe në një institucion të specializuar mjekësor, duke u përshtatur ndihma dhe përkujdesja mjekësore ndaj tij dhe se vazhdimësia e masës të arrestit në burg është në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore. Po kështu, sipas shumicës, ajo gjykatë ka analizuar rastin konkret nëpërmjet një interpretimi sistematik, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 81/2020 dhe dispozitat e KPP-së, përmes të cilave u ka dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkuarit lidhur me cenimin e lirisë personale dhe mosplotësimin e kriterëve për zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg me një masë më të lehtë (*shih paragrafin 48 të vendimit*).

7. Në ndryshim nga shumica, ne, gjyqtarët në pakicë çmojmë se çështja duhej të ishte analizuar nëse ishin përmbushur garancitë procedurale të të paraburgosurit, të parashikuara nga neni 28, pikat 3 dhe 5, të Kushtetutës të lidhura me nenin 25 të saj, dhe jo në këndvështrim të nenit 27 të saj, sikurse

e ka trajtuar shumica. Kjo, pasi kërkuesi në ankimin kushtetues individual nuk ka kundërshtuar caktimin e masave të sigurimit të arrestit në burg *per se*, por ka ngritur pretendime për mënyrën se si është trajtuar nga institucionet publike dhe gjykatat gjatë paraburgimit të tij, kur ato nuk i kanë pranuar kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore. Duke mbajtur në konsideratë thelbin e pretendimeve, vëmë në dukje se neni 28 i Kushtetutës, në pikat 3 dhe 5, parashikon se personi, të cilit i është hequr liria, ka të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjyqtarit, si dhe të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij. Ndërsa neni 25 i Kushtetutës ndalon, ndër të tjera, që kushdo t'i nënshtrohet trajtimit çnjerëzor. Mbi këtë bazë kushtetuese, në vlerësimin tonë për zgjidhjen e çështjes kushtetuese konkrete vlejné tre argumentet kryesore të mëposhtme.

8. *Së pari*, shtetit i lind detyrimi të ofrojë kujdesin e duhur mjekësor ndaj kujtdo dhe në çdo lloj gjendjeje që mund të ndodhet individi, jo vetëm si objektiv social, në kuptimin e përmirësimit të vazhdueshëm të standardit shëndetësor (neni 59 i Kushtetutës), por edhe për shkak se sipas nenit 55 të Kushtetutës shtetasi gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti. Në këtë pikëpamje, shteti ka detyrim të shtuar për të ofruar kujdesin e duhur mjekësor ndaj atyre që ndodhen në kushtet e kufizimit të lirisë, të cilët janë të izoluar dhe ndihma eventuale mjekësore mund dhe duhet t'i ofrohet vetëm nga institucionet shtetërore. Sikurse ka theksuar edhe Gjykata në jurisprudencën e saj në rastin e kësaj kategorie individësh, liria e të cilëve është kufizuar sipas ligjit, organet e pushtetit publik kanë detyrime shtesë për të dëshmuar se të drejtat kushtetuese të tyre respektohen dhe, pikërisht për këtë arsye, nenet 27 dhe 28, të Kushtetutës parashikojnë garanci specifike për këtë kategori individësh, ku ritheksohet në mënyrë të veçantë se çdo person, të cilit i është hequr liria, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij (*shih vendimin nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Lidhur me këtë, GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka pohuar se neni 3 i KEDNJ-së i imponon shtetit një detyrim për të mbrojtur mirëqenien fizike të personave të privuar nga liria, duke u ofruar, ndër të tjera, kujdesin e nevojshëm mjekësor (*shih Kudla kundër Polonisë [DhM], datë 26.10.2000, § 94*). “Përshtatshmëria” e ndihmës mjekësore mbetet elementi më i vështirë për t'u përcaktuar. Kështu në rast të mendimeve të ndryshme mjekësore për kujdesin e nevojshëm mjekësor, mund të jetë e nevojshme që autoritetet e burgut dhe gjykatat vendase, në mënyrë që të përmbushin detyrimin e tyre pozitiv, sipas nenit 3, të marrin mendim shtesë nga ekspertë të specializuar (*shih Wenner kundër Gjermanisë, datë 1.9.2016, § 57*). Për më tepër, trajtimi mjekësor i ofruar brenda mjediseve të burgut duhet të jetë i përshtatshëm, pra në një nivel të krahasueshëm me atë që autoritetet shtetërore janë zotuar t'i ofrojnë popullatës në tërësi (*shih Blokhin kundër Rusisë [DhM], datë 23.3.2016, § 137*).

10. Edhe në analizë të nenit 5 të KEDNJ-së, ajo gjykatë ka theksuar se ndonëse neni 5 i Konventës “nuk imponon një detyrim për gjyqtarin për t'i kthyer përgjigje çdo pretendimi të kërkuesit, thelbi i garancive të tij do të cenohej nëse gjyqtari, duke u mbështetur në ligjin dhe praktikën e brendshme, do të trajtonte si të parëndësishme, ose të shpërfillte fakte konkrete të paraqitura nga i paraburgosuri, të cilat do të vinin në dyshim ekzistencën e kritereve për “ligjshmërinë” e heqjes së lirisë, në kuptimin e Konventës” (*shih Nikolova kundër Bullgarisë [DhM], datë 25.8.1999, § 61*). Në këtë kontekst, “argumentet pro dhe kundër lirimit nuk duhet të jenë “të përgjithshme dhe abstrakte”” (*shih Smirnova kundër Rusisë, datë 24.7.2003, § 63*).

11. Në zbatim të standardeve të mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se në rastet e kufizimit të lirisë personale, shtetit i lind detyrimi i shtuar për të ofruar kujdesin e nevojshëm mjekësor. Detyrimi kushtetues për trajtimin njerëzor të të paraburgosurve, që sanksionohet në nenin 28, pika 5, të Kushtetutës, rezulton i përmbushur në nivel ligjor nga ligji nr. 81/2020, i cili përmban garancitë për gjendjen shëndetësore, të cilat janë vënë në dukje edhe nga gjykatat e zakonshme (*shih paragrafin 57 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në shtesë, edhe vetë KPP-ja i jep të drejtën të paraburgosurit që të paraqesë në gjykatë kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit kur nevojat e sigurimit zbuten (*neni 260*) dhe, gjithashtu, vë në dukje se arresti në burg nuk mund të caktohet ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë (*neni 230*).

12. Po kështu, jemi të mendimit se edhe korniza institucionale rezulton të jetë në funksion, pra të paraburgosurve u ofrohet shërbimi i kujdesit shëndetësor gjatë kohës së qëndrimit në institucion, përfshirë edhe spitalin e burgjeve. Lidhur me këtë, progresraporti i vitit 2023 i Komisionit Evropian

për Shqipërinë, për sa i përket parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit, ka konstatuar se stafi mjekësor dhe ai mbikëqyrës në spitalet e burgjeve është përgjithësisht i kënaqshëm, si dhe nuk është raportuar asnjë keqtrajtım thelbësor në burgje ose nga policia, por Avokati i Popullit nënvizon nevojën për të përmirësuar standardet minimale për kushtet sanitare në burgje dhe mjediset policore (*shih faqet 29–30 të progresraportit*).

13. Së dyti, shtetit i lind detyrimi të ofrojë jo vetëm kujdesin e duhur mjekësor, por ai duhet të jetë i përshtatshëm, i plotë dhe efektiv. Në rastin konkret, konstatojmë se pas paraqitjes së kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, gjykata e shkallës së parë ka caktuar një grup ekspertësh të Institutit të Mjekësisë Ligjore për kryerjen e aktit të ekspertimit për gjendjen shëndetësore të kërkuarit. Në përfundim, ekspertët kanë konkluduar përpara gjykatës se *“gjendja aktuale shëndetësore e të hetuarit Lefter Koka, është veçanërisht e rëndë. Sëmundjet nga të cilat vuan shtetasi Lefter Koka nuk mund të kurohen në kushtet e paraburgimit, në ambientet e IEVP, në të cilat ndodhet. Qëndrimi në izolim, në kushtet e paraburgimit, referuar diagnozës së të hetuarit, përbën rrezik për shëndetin e tij”*. Pavarësisht këtij konkluzioni, gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se sëmundjet që i janë diagnostikuar kërkuarit mund të ndikojnë në gjendjen e tij shëndetësore kudo që të ndodhet, pasi trajtimi i tyre është i njëjtë si në kushtet e paraburgimit, ashtu edhe në mjediset e tjera, prandaj nuk ka vend për zbutjen e masës. Lidhur me këtë, shumica është shprehur se Gjykata e Lartë ka arsyetuar vazhdimin e masës së sigurimit duke konsideruar kushtet mjekësore të kërkuarit, nuk është provuar pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese, qoftë në institucionin mjekësor kur trajtohen të paraburgosurit, ashtu edhe në një institucion të specializuar mjekësor, si dhe verifikimi i vazhdimësisë së masës së arrestit në burg është në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore.

14. Nuk pajtohem me këtë arsyetim, pasi nisur nga përmbajtja e këtij akti dhe mënyra se si janë shprehur gjykatat, të cilat nuk e kanë konsideruar atë bindës, atyre u lindte detyrimi për të kërkuar një ekspertim të ri, i cili do të përcaktonte nëse kushtet konkrete përputheshin ose jo me kriteret e ligjit procedural penal për zëvendësimin e masës së sigurimit.

15. Gjithashtu, nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore rezulton se gjykatat nuk kanë kryer hetim në lidhje me përshtatshmërinë e trajtimit mjekësor brenda mjediseve të burgimit, por janë mjaftuar me trajtimin teorik të legjislacionit procedural penal. Thjesht parashikimi në ligj i të drejtave të individit nuk garanton edhe përmbushjen e standardit, pasi ajo që merr rëndësi është zbatimi efektiv në praktikë i tyre. Thënë kjo, gjykatat nuk u kanë kthyer përgjigje pretendimeve të kërkuarit, të cilat mbështeteshin në një masë edhe nga konkluzionet e ekspertëve. Ato kishin detyrimin për të arsyetuar në mënyrë shteruese shkakun se përse nuk kanë pranuar të mbështesin vendimmarrjen e tyre në aktin e ekspertimit, me qëllim përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit. Përkundër kësaj, gjykatat janë mjaftuar me një arsyetim të përgjithshëm dhe abstrakt, i cili nuk i përgjigjej rastit konkret. Një mangësi e tillë nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë, e cila, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, duhej të shprehej në lidhje me këtë qëndrim të mbajtur nga gjykatat më të ulëta. Për pasojë, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se vendimet gjyqësore kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit.

16. Për më tepër, konstatojmë se gjykatat kanë refuzuar të mbështeten te mendimi i ekspertëve me arsyetimin se ai nuk është detyrues dhe sëmundjet me të cilat është diagnostikuar se vuan kërkuari mund të ndikojnë në gjendjen e tij shëndetësore, pavarësisht vendndodhjes së tij, kudo që të ndodhet, në mjediset e shtëpisë, në mjediset e IEVP-së, ose në Institutin e Veçantë të Kujdesit Shëndetësor të të Burgosurve. Në këtë drejtim, duhet evidentuar se gjykatat kanë shmangur lehtësisht mendimin e specializuar të ekspertëve mjekoligjorë, pa marrë në konsideratë faktin se këta të fundit janë pjesë e Institutit të Mjekësisë Ligjore, i cili është një institucion qendror buxhetor, në varësi të ministrit të Drejtësisë që ka nën përgjegjësinë e tij, ndër të tjera, kryerjen e ekspertimeve mjekoligjore, si dhe veprimeve të tjera, në përputhje me legjislacionin procedural penal.

17. Për sa më lart, vlerësojmë se autoritetet shtetërore dhe gjykatat kanë dështuar në përmbushjen e detyrave të tyre për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të kërkuarit në përputhje me garancitë kushtetuese, duke vënë në dyshim mbi të gjitha trajtimin njerëzor të të paraburgosurit.

18. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuari ishte i bazuar, ndaj Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin e kërkesës.

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari